



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



| | | | |
|--------------------------------------|-------------|----------------|---------------|
| Pranuar - Priliko Më/Dana 10.11.2016 | | | |
| Nr. i Organi | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vredno. |
| | 02-013/1436 | | |

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Ne mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 19 të Rregullores nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive Jo financiare në Organizata Buxhetore, dhe Udhëzimit Administrativ nr 21/2009 për Menaxhimin e Pasurisë Qeveritare, Kryetari i Komunës së Vitisë merr këtë:

V E N D I M

PER FORMIMIN E KOMISIONIT PER INVENTARIZIMIN E PASURISE SE KOMUNES
NËN 1.000,00€ PËR ADMINISTRATËN KOMUNALE

- I. Për inventarizimin e pasurive të Komunës formoj Komisionin në këtë përbërje:
1. Perparim Sadiku, Kryesuesi
 2. Enes Pira, anëtar
 3. Mustafë Islami, anëtar
- II. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit

Komisioni në pajtim me Rregulloren MF. nr 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Qeveritare Organizata Buxhetore ka për detyrë dhe përgjegjësi si vijon:

1. Inventarizimin e të gjithë pasurisë jo financiare që është në pronësi dhe në kontroll të Komunës;
2. Verifikimin fizik dhe cilësor i gjendjes së pasurisë jo financiare;
3. Krahasimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare;
4. Identifikimin e pasurisë që nuk ka vlerë të bartur;
5. Identifikimin e pasurive të dëmtuara dhe jashtë përdorimit;
6. Përgatitjen e raportit për kryerjen e inventarizimit;
7. Hartimin e raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të Komisionit për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare jo më larg se 10 janar 2017.

III. Me kopjen e këtij vendimi njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga kryetari i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Anëtarëve të komisionit,
2. Zyrës së Kryetarit,
3. Drejtorisë për Financa,
4. Arkivit

Viti, 09.11.2016

KRYETARI I KOMUNËS

Sokol Haliti

